



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KONSULTATIV I BIZNESIT

Mbledhja e Keshillit Konsultativ te Biznesit,
E marte, 20.03.2007, ora 11.00

Sot me date 20.03.2007 ora 11.00 prane ambjenteve te Ministrise se Ekonomise Tregtise dhe Energjetikes (METE) u zhvillua mbledhja e rradhes e Keshillit Konsultativ te Biznesit (KKB) duke ndjekur kete rend dite:

1. Keshilli Konsultativ i Biznesit u informua mbi projektligjin per Regjistrimin e Biznesit, te miratuar tashme nga Keshilli i Ministrave me 14 mars 2007, dhe qe do t'i paraqitet Parlamentit per miratim. Ligji i ri percakton krijimin e Qendres Kombetare te Regjistrimit (QKR) si nje institucion publik qendror, me personalitet juridik, ne varesi te Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes (METE). Ky ligj eshte nisme e Qeverise se Shqiperise dhe METE mbeshtetur nga projekti i Marreveshjes se Pragut te Sfides se Mijevjeçarit per Shqiperine zbatuar nga USAID.

2. U diskutua mbi Draft-Strategjine e Biznesit dhe te Investimeve 2007-2013, nje nga strategjite sektoriale me te rendesishme e cila pas nje procesi te gjere konsultimi te nisur tashme, do te miratohet nga Keshilli i Ministrave. Kjo strategji u pergatit nga eksperte te Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes me konsulencen e eksperteve te Bankes Boterore dhe te botes akademike shqiptare (materiali gjendet ne rubriken “akte ne proces konsultimi”)

Mbledhja u kryesua nga Kryetari i KKB-se Z. Genc Ruli, dhe moren pjese shumica e anetareve.